

• **Projekt Idea:**

Ngritja e kapaciteteve njerezore per menaxhimin strategjik portual, përmes projekt- idesë, “Porti intermodal i Sarandës - Përmirësimi në pikën nyje të transportit të rrugëve te shkurtra detare dhe autostradave të detit, në rajonin e Iniciativës se 3 deteve, Adriatik, Jon dhe te Mesdheut”

• **Qellimi dhe benefitet:**

Ne saje te ketij programi ne kerkojme permiresimin me standarte evropiane, realizimin dhe zgjidhjen e problematikave qe hasim gjate perditshmerise ne Portin e Sarandes. Mbi kete Port strategjik jugor vemendja e Qeverise Shqiptare ka qene maksimale per te permiresuar gjithë elementet dhe duke e promovuar Portin gjeresisht ne takime nderkombetare.. Sipas vendimit per Miratimin e Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim 2016-2020, prioritet i eshte dhene turizmit. Per kete arsye jane vendosur objektiva strategjik te krijimit te nje modeli te integruar per te arritur nivelin e kerkuar dhe duke patur nder prioritetet kryesore ne vecanti Portin e Sarandes permendur ne kete Strategji si me poshte:

“Porti i Sarandës

Porti i Sarandës është porti më jugor i Shqipërisë dhe porti i dytë më i vogël për përpunimin e pasagjerëve dhe turistëve nga katër portet kryesore. Porti ndodhet përballë ishullit të Korfuzit dhe është zakonisht porti i lëvizjes nga/për në Greqi. Për shkak të shtimit të madh të turizmit në Sarandë gjatë disa viteve të fundit dhe sic porti ka dëshmuar një rritje të konsiderueshme në trafikun e lundrimit dhe turizmit detar; kjo, kundër një rënie të dukshme të trafikut të mallrave që po bëhet pothuajse i papërfillshëm. Aktualisht, porti i Sarandës është e ndarë në portin e vjetër dhe të ri, pas një programi zgjerimi të kohëve të fundit për të akomoduar anijet lundruese në terminalin e saj. Në afat të gjatë, Qeveria Shqiptare planifikon ta transformojë Portin e Sarandës në një portë hyrëse për turizmin dhe tregtinë në jugun e Shqipërisë. Zhvillimi i planifikuar përfshin veprimet e mëposhtme:

- Integrimi i te gjithë portit me kapacitetet njerezore dhe teknologjise ITS
- Parashikimi i aspekteve te legjislacionit kombetar dhe atij evropian BE
- Menaxhim i suksesshem projekti i cili permban trajnimet e kapaciteteve
- Vendosja sistemit integruar shqiptar te informacionit financiar AFMIS
- Vendosja e sistemit te performances se portit sipas algoritmit te miratuar
- Vendosja e sistemeve te paralajmerimit te stuhive detare dhe mirembajtje
- Vendosja e sistemeve te paralajmerimit ne kohe reale per udhetaret tane
- Certifikimi sistemit te testit pilot algoritmik sic eshte miratuar brenda FS
- Rivendosja e bankinës ekzistuese për mallrat në Gjirin e Sarandës në një kalatë vetëm për mallrat brenda Gjirit të Limionit duke përfshirë çdo mbrojtje të nevojshme dallgëthyes kundër dallgëve;
- Konvertimi i kalatës ekzistuese të mallrave në Sarandë në një kalatë për anijet cruise.
- Ndërtimi i një marine të re për jahtet pranë kalatës së re të anijeve lundruese.
- Një zgjerim i faciliteteve turistike në portin e Sarandës nëpërmjet krijimit të një porti të dedikuar për përpunimin e anijeve cruises dhe mjeteve të tjera

lundruese turistike.”

- ***Objektivi i investimit***

Zhvillimi i infrastruktures portuale me perfshirjen e kalates ekzistuese dhe transformimin ne nje kalate kruazjerash, ndertimin e infrastruktures mbeshtetese duke u bazuar ne shfrytezimin e burimeve alternative te energjise elektrike te qendrueshme, reduktimin e dioksidit te karbonit dhe ne nje qasje sa me miqesore me mjedisin si dhe me perfshirjen e komunitetit ne vendimmarrje. Realizimi i ketij investimi do te mundesoje realizimin e objektivave si me poshte:

- Transformimin e Portit tone ne nje pike Nodale ne zonen e Adriatikut dhe Jonit
- Permirosimin e hyrjes ne tregje te reja
- Rritjen e vendeve te punes
- Rritjen e kapaciteteve te pasagjereve qe mberrijne ne Port
- Zhvillimin e zonave turistike.